

ORGANIZATA PËR REPUBLIKË - PKMLSHJ

Fakte, dokumente dhe dëshmi

Demonstratat gjithëpopullore me 26 mars e 1, 2 e 3 prill 1981 dhe ato të mëvonshme janë rezultat i (bashkë-)veprimit të pjesëtarëve të grupeve e organizatave të ndryshme, por edhe të individëve, grupeve e shoqërive, formalisht te paorganizuara politikisht. Ky shkrim dokumentues i takon një pjese të një serie shkrimesh me dëshmi, aktgjykime, aktakuza e botime dhe me fakte plotësuese që hedhin dritë mbi organizimin e kërkesës së shtruar në demonstratave e vitit 1981 për Republikë Shqiptare dhe forcave organizuese të saj, si dhe mbi individët dhe grupet e organizuara që ndër të tjera kanë vepruar kryesisht nga platforma politike për Republikë.



Pamje nga demonstratat e 1 prillit 1981 në Prishtinë

Tërë këtë trajtim, për aq sa mundemi do të përpiqemi ta bëjmë në mënyrë sa më objektive dhe duke njohur e respektuar faktet e deritashme të ditura të veprimtarisë atdhetare e përparimtare të individëve, grupeve e organizatave të organizuara që kanë vepruar edhe nga platforma dhe me kërkesa tjera ideologjike, politike e atdhetare, qoftë paqësore e oportuniste në kuadër të strukturave e institucioneve të sistemit, qoftë aktive e revolucionare në kuadër të rezistencës dhe luftës kundër sistemit të huaj të padrejtë, pushtues, shtypës e shfrytëzues me përpjekje deri edhe shfarosëse.

ROLI I VEPRIMTARËVE TË “PAORGANIZUAR”

Qysh në fillim të këtij shkrimi duhet theksuar të vërtetën se: Në prag të demonstratave të vitit 1981, u shtua dukshëm jo vetëm numri i individëve, por edhe i grupeve e organizatave politike shqiptare, të cilat për shkak të rrethanave të atëhershme ishin të detyruara të vepronin në ilegalitet qoftë të pjesshëm qoftë të plotë. Përpos grupeve formale e joformale si dhe organizatave atdhetare dhe revolucionare të kohës, shumë i rëndësishëm ishte edhe roli dhe veprimtaria e individëve e personalitete të ditura e të atillëve që edhe sot e kësaj dite kanë mbetur anonim. Roli dhe ndikimi i këtyre individëve dhe personaliteteve para, gjatë dhe pas demonstratave të famshme të vitit 1981 ka qenë shumë i rëndësishëm dhe në situata të caktuara edhe kultivues, e i cili herë-herë ia ka kaluar edhe subjekteve të organizuara të kohës. Kjo vlen të theksohet edhe nga fakti se në shkrimet e trajtimet, por edhe në librat e shumtë të publikuar mbi këtë tematikë, po këta individë padrejtësisht të heshtën deri edhe të injorohen.

NJËANSHMËRIA NGA POZITAT E KUNDËRTA

Se çfarë qëndrimesh dhe veprimesh kanë mbrojtur asokohe grupet e organizatat ekzistuese, dihet botërisht. Ata që nuk e dinë, këshillohen të konsultojnë dhe tu referohen programeve dhe aktiviteteve të strukturave të kohës.



Gazetat „REVOLUCIONI“ e „ZËRI I ATDHEUT“ të nxjerra në ilegalitet në Prishtinë e Ferizaj në verë 1981


Meritat që individë të caktuar, me peshë në sistem mund të kishin sa i përket avancimit të çështjes kombëtare e shoqërore, do të duhej tu mjaftonin atyre, për të mos pasur nevojë të injorojnë të tjerët, apo siç bëri e vazhdojë të bëjë pjesë e bashkëpunëtorëve fanatic shqipfolës të pushtetit serb e jugosllav, të cilët nuk u mjaftuan vetëm me shpifjet e intrigat kundër kërkesave dhe veprimtarisë së kohës, por edhe urdhëruan ushtrimin e represionit individual, grupor e kolektiv, bile edhe ushtrimin e torturës çnjerëzore deri në mbytje karshi të burgosurve politik (siç është rasti me Fazli Grajçevcin, Afrim Abazin, e të tjerë), deri edhe cytjen e inskenimeve dhe nxitjen e pjesëtarëve të lëvizjes ilegale kundër njeri tjetër si në burg ashtu edhe jashtë tij. As atëherë e as tani akushn nuk është përgjegj ligjërisht për torturat e ushtruara dhe mbytjet gjatë hetimeve, gjë që de jure edhe atëherë ka qenë e ndaluar me ligjete në fuqi.

Zyrtarët shqipfolës të sistemit, si pjesë përbërëse e pushtuesve, herë hapur e herë fshehur në luftën e tyre speciale kundër kërkesës ultimative për Republikë, aludonin p.sh. se; demonstratat e shqiptarëve për republikë i kanë organizuar herë UDB-ja e Serbia, herë KGB e Rusia e deri edhe Bullgaria, apo edhe se: “armiku i brendshëm reagon në bashkëpunim me atë jashtëm imperialist”, siç thoshin ata, për të përfunduar se ato ishin të nxitura e organizuara nga Shteti amë i shqiptarëve dhe PPSH-ja, vetëm pse këta të fundit kryenin më të voglin obligim kushtetues dhe kombëtar. Kur ua lypte puna ata – me perfiditet - te vendet që dominoheshin nga politikat djathta atakonin kërkesat dhe lëvizjen tonë si revolucionare e ultra të majtë, ndërsa tek vendet që dominoheshin nga politikat e majta si reacionare e ultra të djathtë. Bile për këtë qëllim ata bënë publikime e shkrime të veçanta, të cilat i shpërndanin sipas këtyre nevojave.

Më poshtë në shkrim do të publikojmë pjesë dokumentesh dhe dëshmish (duke dhënë edhe burimet) që ndriçojnë të vërtetën dhe plotësojnë zbrazëtitë e shumta të krijuara qoftë rastësisht apo qëllimisht.

ÇKA DËSHMOJNË DOKUMENTET DHE QËNDRIMET E KOHËS

Se regjimi ishte në dijeni se do të vinte te demonstratat me këtë kërkesë, dëshmon më së miri edhe “RAPORTI I KOMISIONIT PËR PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË MAHMUT BAKALLIT”. Në gazetën “RILINDJA” të datës 26.9.1981 botohet teksti i këtij raporti, i cili në kapitullin e parë të tij tërësisht i përkushtohet aktivitetit të PKMLSHJ-së para shpërthimit të këtyre demonstratave; se Institucionet informohen për kërkesën për Republikën shqiptare të Kosovës të shtruar qysh nga viti 1978... Aktiviteti i PKMLSHJ-së përshkruhet në mënyrë kronologjike, po në ato rrjedha se si kanë arritur dokumentet e saja në adresat e partisë në pushtet. (Botuar në gazetën “Rilindja”, të datës 26.9.1981)



Pamje e Librit të Sinan Hasanit "Të vërtetat dhe mashtrimet" në gjuhën serbokroate Po i njëjti është i botuar edhe në gjuhën shqipe

Ndër të tjera në këtë libër për PKMLSHJ ipen edhe këto të dhëna

"...Kjo Organizatë prej marsit 1979 deri në demonstratat kundërrevolucionare i dërgoi me postë këto materiale:

- *më 1 mars 1979 në adresën e kryetarit të Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës u dërgua informata e grupit nga Obiliqi;*
- *më 27 mars 1979 në adresën e anëtarit të Kryesisë së KK të LK të Kosovës u dërgua 'informata mbi situatën politike e ekonomike';*
- *më 15 mars 1980 iu dërgua telegram Kryesisë së KQ të LKJ;*
- *më 1 nëntor 1980 në adresën e kryetarit të Kryesisë së KSA të Kosovës u dërgua letra e KQ të PKMLSHJ;*
- *më 30 nëntor 1980, në adresën e kryetarit të Kryesisë së KSA të Kosovës arrin letra e Komitetit Qarkor të PKMLSHJ për krahinën shqiptare nën pushtetin e Malit të Zi;*
- *në gjysmën e dytë të nëntorit 1980 në formë broshure u dërgua "Programi e statuti" i kësaj organizate në 147 faqe...*
- *më 15 prill 1981, Kryesia e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës mori "Notën" në të cilën ...kjo organizatë merre përgjegjësinë për organizimin e demonstratave...;*
- *prej 14 prillit 1981 edhe në nëntë raste shpërndau pamflete, trakte e revista të ndryshme, letra kërcënuese e letra të tjera...*
- ...

...Më tej, pas numërimit edhe të aksioneve tjera të PKMLSHJ, Sinan Hasani shkruan edhe për bashkëveprimin e ilegales, si në vijim: “...GMLK dhe PKMLSHJ me anë të anëtarëve të vet, mbanin kontakte të caktuara, mirëpo sa ishte e fortë kjo lidhje dhe sa bashkëpunonin ato në faza të ndryshme të ekzistencës së tyre, nuk është ndriçuar mjaftë, por dihet se disa anëtarë të PKMLSHJ kishin materiale të GMLK dhe se në demonstrata kanë marrë pjesë bashkërisht...”.

9) U Uroševcu se oglašila grupa pod nazivom „Šota Galica“ sa 18 članova, koja je delovala i na području Gornjeg Nerodimlja. Predstavljala je ostatak organizacije KMLPAJ na tom području, a formirao ju je 1981. godine Fehmi Hajrulahu, koji je pre toga osuđivan zbog neprijateljskog rada. I njeni članovi su polagali zakletvu pred nacionalnom zastavom i plaćali članarinu. Do svog hapšenja grupa je izvela 22 neprijateljske akcije. Ona je organizovala skvrnavljenje pravoslavnog groblja i oštetila sedam spomenika.

Pjesë nga libri i Sinan Hasanit, botim në gjuhën serbokroate nga “Qendra për informata dhe publicitet” 1986, Zagreb

Në këtë libër të tij, faqe 347, Sinan Hasani veçon edhe grupin i të rinjve (të gjithë të mitur) “Shote Galica” që vepronte nga platforma e PKMLSHJ, i themeluar nga veprimtari Fehmi Hajrullahu, ish i burgosur politik dhe veteran i UÇK-së (nga zonën e Noredimës). Ky grup u krijua kryesisht nga familjarë të Fehmiut dhe shokëve të tij dhe, edhe pse të mitur, janë dënuar me shumë vite burg në vitin 1983. (shih edhe: PPPm Nr. 111/83, 5.XII.1983). Për më shumë shih edhe vështrimin e plotë dokumentues në vegën vijuese: http://prointegra.ch/1981_pkmlshj/.

PARULLA EDHE KUNDËR DALLIMEVE SOCIALE, BUOKRACISË DHE EKSPLOATIMIT!

Në një artikull mbi demonstratat e vitit 1981, duke u thirrur në dokumentacionin e ruajtur në Arkivin e Republikës së Maqedonisë, autori Qerim Lita në të përditshmen informative KOHA, të datës 03 prill 2011 ndër të tjera shkruan:




Pamje nga Libri i Qerim Litës “Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990”

“...Gjithashtu është e rëndësishme të vëmë në dukje se për dallim nga dita e parë, demonstratat që u organizuan më 26 mars, pastaj ata të 1- 3 prill, patën një përmbajtje me karakter politik. Në kuadër të demonstruesve që formuar shtabi për organizimin e demonstratave. Për shkakë sigurie, anëtarët e shtabit vepronin ilegalisht dhe një numër shumë i vogël kishin njohuri për ekzistimin e tij. Krahas veprimtarisë së ndryshme informative e organizative, shtabi përpiloi edhe listë të parullave që do të përdorehin gjatë demonstratave, disa prej të cilave po i paraqesim në vazhdim: “... **‘Poshtë dallimet sociale’, ‘Poshtë borgjezia’, ‘Poshtë burokracia’, ‘Poshtë eksploatimi i Kosovës’, ‘Poshtë hegjemonizmi’, ‘Poshtë kolonializmi’, ‘Kërkojmë pavarësi’, ‘Kërkojmë kushte’, ‘Poshtë mashtrimi’, ‘Kërkojmë barazi’, ‘Kërkojmë Republikë’, ‘Kërkojmë bashkimin e mbarë trevave shqiptare në një Republikë’, ‘Poshtë tradhtarët’, ‘Poshtë kolonialistët’, ‘Nuk ka paq pa liri’, ‘Nuk ka barazi pa pavarësi’, ‘Nuk ka barazi pa Republikë’, ‘Nuk do të ketë paqe për tradhtarët e mashtruesit’, etj...**”

KËRKESË SFIDUESE PËR POLITIKËN SHTETËRORE TË JUGOSLLAVISË

Veprimtarit i dalluar i ilegales dhe të luftës çlirimtare Ahmet Qeriqi, në romanin “BURGU”, -botim i vitit 2004, në Prishtinë, trajton aspekt të Lëvizjes sonë të atëhershme. Dilaver Goxhaj (Shpetim Golemi) në shkrimin me titull: DRITHËRIMAT E BURGJEVE NË JUGOSLLAVI (mendime rreth romanit: “Burgu”) ndër të tjera shkruan: “...Edhe midis të burgosurve politikë shqiptarë të viteve tetëdhjetë, kur shtjellohen ngjarjet e romanit, kemi një ndarje, e cila del qartë përmes personazheve dhe dialogjeve të tyre. Grupi më i respektuar ndër ta ishte Grupi Marksist Leninist i Kosovës, të cilët kërkonin idealen, bashkimin me Shqipërinë... Të ishte pjesëtar apo simpatizant i këtij grupi, llogaritej se ishte në rrugë të drejtë dhe në linjë të drejtpërdrejtë me politikën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Edhe Eknat Malmiri e simpatizon këtë grup, por meqë ai është një studiues kritik i teorisë marksiste, njëkohësisht edhe studiues dhe lexues i drejtimeve të tjera filozofike dhe i letërsisë artistike, ai anon nga grupi i Partisë ML të Shqiptarëve të Jugosllavisë, të cilët në programin e tyre kishin krijimin e republikës shqiptare në Jugosllavi, ku të përfshiheshin të gjitha trojet shqiptare të federatës. Kjo ishte një kërkesë, e cila e sfidonte më së tepërmi politikën shtetërore të Jugosllavisë, por që sfidohej nga anëtarët e GMLK-së, të cilët këtë organizatë e pranonin me rezervë...



Pamje nga kopertina e librit të Ahmet Qeriqit “Burgu”

Ekmati, edhe pse bënte pjesë në grupin e Lëvizjes Çlirimtare për Bashkim, por falë rezistencës së tij dhe organizimit nuk ishte dekonspiruar, ai do të duhej të ishte në anën e PKMLSHJ, pasi analiza që ai i bënte

programit të tyre i dukej më përfitues e më pragmatist, pasi i tubonte gjithë shqiptarët e ish Jugosllavisë në një republikë të vetme, duke i evidentuar më tej jo si kombësi, por si komb dhe bëheshim republika e tretë për nga madhësia në federatën jugosllave....”

ORGANIZATA QË NDRYSHOI PROGRAMIN TRADICIONAL TË ILEGALES

Veprimtari tjetër Ethem Çeku, në librin e tij “STRUKTURA POLITIKE E ILEGALES SË KOSOVËS”, botuar nga Argeta- LMG, Tiranë 2006, nën përkujdesjen e Prof. Dr. Shaban Sinani, ndër të tjera (faqe 80) shkruan: *“... Për herë të parë, një organizatë ilegale në Kosovë do ta ndryshojë programin tradicional të ilegales në Kosovë: PKMLSHJ angazhohet vetëm (në këtë fazë – v. i.) për republikën shqiptare në Jugosllavi, pa e përmendur fare çlirimin plotë të tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë...”*. **Më këtë rast më duhet të theksoj faktin se si duket autori nuk e ka konsultur, asnjë nga pjestarët e kësaj organizate dhe nuk e lexuar fare programin dhe platformën e PKMLSHJ, e cila thekson se në rast se nuk arrihet që kërkesa për barazi politike, ekonomike territoriale të shqiptarëve në Jugosllavi përmes krijimit të Republikë Shqiptare të Kosovës të realizohet përmes bisedimesh dhe në mënyrë e rrugë paqësore, dhe se nëse jemi të detyruar të kalojmë në fazën e tretë dhe të organizojmë luftë të armatosur, atëherë kjo do të bëhet për bashkim me shtetin amë – Shqipërinë! – v. i.);**



“...Në këtë fazë të veprimtarisë së ilegales shqiptare në Kosovë do të shtrohet një çështje shumë e rëndësishme, siç ishte problemi i unifikimit të organizatave e grupeve ilegale në një lëvizje unike a në një front gjithëpopullor.” (siç u kishte kërkuar disa herë PKMLSHJ forcave tjera politike – v. i.)

ASOKOHE KISHIM PAKICË PËR BASHKIM KOMBËTAR

Veprimtari i mirënjohur Ramadan Pllana, njëri nga drejtuesit kryesorë të Lëvizjes atdhetare ilegale (LNCKVSHJ), në mënyrën më objektive prononcohet dhe merr qëndrim mbi veprimtarinë, orientimet programore, kërkesat dhe platformat politike të Lëvizjes atdhetare ilegale të kohës. Ai në shkrimet e tija (<http://hogoshti.blogspot.ch/2011/10/xhavit-haziri-heri-i-merituar-nga.html>) dhe intervistat e dhëna (<http://hogoshti.blogspot.ch/2011/10/ramadan-pllana-interviste-ne.html>), thekson në vazhdimësi se **LNCKVSH dhe OMLK kanë pasur program të njëjtë apo të përafërt për bashkim me shtetin amë, ndërsa PKMLSHJ, thotë ai me të drejtë ishte E VETMJA ORGANIZATË QË KA PASUR PLATFORMË DHE KA PUNUAR PËR REPUBLIKË** qysh para viteve të 80-ta (vërejtje e O. O.). Në vijim edhe disa pjesë citimi: *“Kurse, PKMLSHJ ..., po e përsëris, ka qenë e vetmja organizatë që e ka pas programin e saj për Republikën e Kosovës. Këta, e kanë shfrytëzuar masën, në demonstratat e '81-it , për Kosovën Republikë, kurse, ne vetëm për bashkim kemi qenë, ...kanë qenë 2 parulla kryesore në demonstrata : Bashkim-Bashkim, pastaj këta kanë depërtuar dhe e kanë përhapur parullën, Kosova Republikë. Kështu që, në njëfarë mënyre, mbetëm edhe pakicë për bashkim kombëtar. Pastaj, edhe shumica e shokëve tanë ishin ende në burgje, të '81-itës, edhe ata që dilnin, me shumicë dilnin jashtë, në Mërgatë, ...”*

PLOTËSIM I KËRKESËS PËR PARTI KOMBËTARE

Ibrahim Qavolli, Konsulli i Shqipërisë deh njëherazi i dërguari i posaçëm i KQ të PPSH-së në Stamboll të Turqisë, në pjesën e dytë të librit të tij “Jam Kosovar...!” 2008, NB “Gjon Buzuku”, ndër të tjera (faqe 199) shkruan: *“...Me sa di unë, autorësinë e demonstratave të vitit të madh 1981: e mori përsipër, grupi i të rinjve të quajtur Partia Komuniste M-L e Kosovës (PKMLSHJ – v. i.), Në fillim nuk dija asgjë për ta. Vetëm se, më qe dhënë porosia që, t'i prisja e të bisedoja hollësisht, në se vinin e paraqiteshin. Me të vërtetë, ata erdhën, por, për fat të keq, unë nuk qëllova aty. I pritë e bisedoi Ali Ymeri...”*. Duke vazhduar më tej (faqe 201) *“...Ra fjala, për partinë që kishin formuar. Ai (Abdullah Prapashtica – v. i.) , me të drejtë, kishte vënë re se, mungesa e një partie kombëtare që gjatë Luftës NÇL kishte sjellë pasoja negative në fatin e statusit të Kosovës. Maqedonët që e patën krijuar një parti të tillë kombëtare, fituan statusin e republikës, ndonëse me popullsi më të pakët se ne...”*




Pamje e librit të autorit Ibrahim Çavolli “Kujtime, mbresa, pershtatje, te nje mërgimtari”

Pjesën e librit të ish konsullit të shteti Shqiptar në Stamboll të Turqisë, Ibrahim Çavolli që trajton Organizatën PKMLSHJ dhe revokon kujtimet me disa nga drejtuesit e PKMLSHJ-së të arratisur në nëntor të vitit 1981 fillimisht në Turqi mund ta lexoni në vegën vijuese:

<http://www.pashtriku.org/index.php?kat=64&shkrimi=540>

ALFABETI YNË POLITIK FILLOI ME PKMLSHJ

Në librin mbi veteranin ndër më kryesorët të lëvizjes sonë kombëtare ISMAIL DUMOSHI të Prof. Dr. Izber Hotit, botuar nga SHB “Faik Konica” Prishtinë 2011, shoku ynë Hilmi Mehmeti, nip i Ismail e Osman Dumoshit në kujtimin e tij për këtë vepër (faqe 222-223), ndër të tjera shkruan: “... Në vitin 1980, në vjeshtë, data nuk më kujtohet, Osmani erdhi tek unë dhe më tha se dëshiron të takohet me Ismail Dumoshin për të biseduar për një çështje me interes të madh kombëtar. Më vonë e kuptova se Osman Osmani kishte qenë në krye të Partisë (PKMLSHJ), organizatë kjo që veprroi në ilegalitet. Disa herë e kisha dëgjuar (Ismail Dumoshin – v. j.) të fliste me kënaqësi tërthorazi duke thënë se alfabeti ynë fillon me shkronjat PKMLSHJ...”



Pamje e librit të Prof. Dr. Izber Hotit kushtuar veprimtarit të mirënjohur ISMAIL DUMOSHI

ORGANIZIMI I BARABARTË POLITIK I KUNDËRSHTUESHËM ME LKJ-NË

Historiani atdhetar, i burgosuri politik bashkë me Ukshin Hotin me shokë të Grupit të mirënjohur të Intelektualëve të Kosovës, themeluesi i UNIKOMB-it dhe njëri ndër nismëtarët kryesor të luftës çlirimtare, Mr. Halil Alidema, në punimin e tij të botuar në gazetën Rilindja, të datës 20.3.1996, me titullin "Pikëpamje: BUNTI ATDHETAR I PRANVERËS '81", ndër të tjera në pjesën mbi "Rolin prijës të PKMLSH" shkruan, po citojmë: *"Në demonstratat ishin pjesëmarrës partitë, grupet dhe organizatat ilegale. Por në këtë organizim duhej të pranohej roli prijatar i PKMLSH-së. Ajo si parti politike, lindi, u krijua, u organizua dhe u mobilizua aq shpejt saqë brenda një kohe të shkurtër u shndërrua edhe në një motor lëvizës të atyre ngjarjeve. Përveç programit dhe statutit ajo nxori edhe disa urdhëresa dhe dokumente me rëndësi. Ajo njoftoj me guxim të gjitha strukturat e hierarkisë politike jugosllave, komitetet qendrore të Republikave dhe Krahinave dhe vetë Komitetin Qendror të LKJ me informatën Nr. 1, me të cilën verifikohet dhe u bëhet me dije ekzistimi i kësaj partie si forcë e organizuar politike në Kosovë. Njëherit ajo identifikohet si organizëm i barabartë politik i kundërshtueshëm me LKJ-në dhe merret përsipër mbrojtjen dhe shqyrtimin e statusit të shqiptarëve nën Jugosllavi, për të hapur dialogun e bisedimeve për realizimin e proceseve të vetëvendosjes deri në shpëtim të shqiptarëve nga ish-Jugosllavia. Njëherit ajo me dokumente të tjera paralajmëronte të gjitha strukturat udhëheqëse të Kosovës për pashmangshmërinë e shpërthimit të demonstratave në Kosovë dhe më gjerë me parullën bazë "Kosova-Republikë" duke përfshirë të gjitha territoret me shumicë shqiptare nën ish-Jugosllavi. Kjo parti u mbeti besnike opsioneve dhe kërkesave të veta dhe vërtet ishte partia e vetme në Kosovë që morri publikisht përgjegjësinë për organizimin e demonstratave dhe u zotua për vazhdimin e tyre deri në fitore."*



Roli prijës i PKMLSH

Në demonstrata ishin pjesëmarrës aktivë partië, grupet dhe organizatat ilegale. Por në këtë organizim duhej të pranohej roli prijëtar i PKMLSH-së. Ajo si parti politike, lindi, u krijua, u organizua dhe u mobilizua aq shpejt sa që brenda një kohe të shkurtër u shndërrua edhe në një motor lëvizës të atyre ngjarjeve. Përveç programit dhe statutit ajo nxorri dhe disa urdhëresa dhe dokumenta me rëndësi. Ajo njoftoi me guxim të gjitha strukturat e hierarkisë politike jugosllave, komitetet qendrore të Republikave dhe krahinave dhe vetë Komitetit Qendror të LKJ me informatën Nr.1, me të cilën verifikohet dhe u bëhej me dije ekzistimi i kësaj partie si forcë e organizuar politike në Kosovë. Njëherit ajo identifikohet si organizim i barabartë politik i kundërshtueshëm me LKJ-në dhe merret për-sipër mbrojtjen dhe shqyrtimin e statusit të

shqiptarëve nën Jugosllavi, për të hapur dialogun e bisedimeve për realizimin e proceseve të vetvendosjes deri në shkeputje të shqiptarëve nga ish-Jugosllavia. Njëherit ajo me dokumente të tjera paralajmëronte të gjitha strukturat udhëheqëse të Kosovës për pashmangshmërinë e shpërthimit të demonstratave në Kosovë dhe më gjerë me parullën bazë: "Kosova Republikë" duke përfshirë të gjitha territoret me shumicë shqiptare nën ish-Jugosllavi. Kjo parti u mbeti besnikë obcioneve dhe kërkesave të veta dhe vërtet ishte partia e vetme në Kosovë që mori publikisht përgjegjësinë për organizimin e demonstratave dhe u zotua për vazhdimin e tyre deri në fitore.

Mr. Halil ALIDEMA

...

Pjese te shkëputura nga punimi "BUNTI ATDHETAR I PRANVERËS '81" i veprimtarit atdhetar Halili Alidema, themelues i UNIKOMB-it dhe i celulave të para të UÇK-së

NGA VITI 1975-1978 KONSOLIDOHET ORGANIZATA (PKML) SHQIPTARE PËR REPUBLIKË

PKMLSHJ-ja, që si nismë organizative atdhetare (ORA) daton që nga viti 1975, është organizata e konsoliduar me program, statute e platformë politike në mbledhjen e saj solemne, të mbajtur NË VERË TË VITIT 1978 NË PRISHTINË, (shih. Aktgjykimin P-K.nr. 167/82). Mbledhja solemne është hapur nga Adem Prapashtica, e pastaj është drejtuar nga Osman Osmani dhe Abdullah Prapashtica, me çrast aprovohet platforma politike e saj dhe caktohen edhe detyrat e aktivitetet (shih edhe shkrimin e gazetës Rilindja me rastin e fillimit të gjykimin të pjesëtarëve të Organizatës për Republikë – PKMLSHJ, të datës 8.2.1983). Më 15 shkurt të vitit 1983, Gjykatën e Qarkut, në Prishtinë në bazë të aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë pp.nr. 152/82, 156/82, 158/82, dënoi me 147 vjet burg këta atdhetarë shqiptarë, të cilët kërkonin avancimin e pozitës kushtetuese të Kosovës; **Rexhep Maqedonci, me 14 vjet, Adem Prapashtica me 11 vjet, Nusret Ahmeti me 10 vjet, Kadri Cakiqi me 6 vjet, Adem Dervisholli me 6 vjet, Sabit Gashi me 8 vjet, Skënder Vardari me 8 vjet, Lutfi Maqedonci me 6 vjet, Fatmir Graiçevci me 9 vjet, Bahtir Ahmeti me 6 vjet, Martin Çuni me 8 vjet, Meriman Braha me 7 vjet, Osman Maqedonci**

me 5 vjet, Arban Hoxha me 5 vjet, Ahmet Islami me 5 vjet, Idriz Isufi me 2 vjet dhe Agim Ahmeti (me 1 vjet), të gjithë nga Prishtina, Naim Mahmudi nga Dragonishta e Vogël KK Kërçovë (me 2 vjet), Avdi Krasniqi nga Peja (me 7 vjet), Ahmet Qeriqi nga Shtimja (me 8 vjet), Zenun Gjoci nga fshati Gjocaj (me 6 vjet), Hamëz Morina nga fshati Llashkadrenoc (me 5 vjet), Sallah Jonuzi nga Ferizaj (me 3 vjet),...

FILLOI GJYKIMI I PJESËTARËVE TË ORGANIZATËS ILEGALE
 ARMIQËSORE «PARTIA KOMUNISTE MARKSISTE – LENINISTE E
 SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI»

ME VEPRIM, IDE E PLATFORMË ARMIQËSORE

● Pasi formuan organizatën armiqësore, në verë të vitit 1978, në shtëpinë e Abdullah Prapashticës në Prishtinë, si dhe u njohën me programin dhe ideologjinë e saj, disa nga të akuzuarit përcaktuan detyrat konkrete për aksionet e mëtejme. — Çfarë pseudonimesh kishin të akuzuarit dhe çka u shkruan organizatave shoqërore—politike në Krahinë? — Ditëne parë të shqyrtimit kryesor në pyetje u morën dy të akuzuarit e parë, Rexhep Maqedonci dhe Adem Prapashtica, të cilët deklaruan se nuk pendohen për veprimet e bëra armiqësore

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, para trupit gjyqësor të të pestëve, e kryesor gjyqtari Mentor Çoku, dje filloi procesi gjyqësor ndaj 23 pjesëtarëve të organizatës ilegale armiqësore «Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi», të cilët veprimtarinë e tyre armiqësore ndaj vendit tonë e filluan në vitin 1978 dhe e vazhduan deri në mars të vitit të kaluar. Në fillim të procesit të djeshëm, kryesor nga ana e zëvendësprokurorëve publikë, u lexua aktakuzja, të cilën e përfaqësojnë Ruzhdi Kozmaqi dhe Reshat Millaku, e pastaj filloi marrja në pyetje e të akuzuarve të parë.

Kësaj organizate armiqësore, që të 23 të akuzuarit, kush më herët e kush më vonë, iu bashkuan me qëllime të caktuara dhe ideja, veprimi e platforma e tyre ishte fund e krye armiqësore ngase ata përdoren të gjitha mjetet në luftë kundër sistemit tonë socialist vetpëqeverisës, kundër vëllazërimit — bashkimit e bashkëjetesës e kundër të gjitha fryteve të revolucionit tonë socialist dhe integritetit të vendit tonë. Të akuzuarit (shumica e tyre) Rexhep Maqedonci, Adem Prapashtica, Lutfi Maqedonci, Nusret Ahmeti, Kadri Cakiqi, Adem Dervisholli, Fatmir Grajçevci, Bahadır Ahmeti, Agim Ahmeti të gjithë nga Prishtina, pastaj Martin Çuni nga Gjakova, Neriman Braha nga Prizreni, Osman Maqedonci nga Prishtina, Arban Hoaxha nga Gjilani, Avdi Krasniqi nga Pejë, Naim Mahmudi nga Kërgova Ahmet Qeriqi nga Shumja, Zenun Gjocaj nga Deçani, Hamzë Morina nga Klina, Salah Jonuzi nga Ferizaj, Sabit Gashi nga Prishtina, Skender Vardari, shtetas turk, i lindur në Stamboll, Ahmet Islami si dhe Idriz Jusufi, që të dy nga Prishtina, ishin edhe pjesëmarrës të demonstratave armiqësore e kundërrivolucionare të marsit e të prillit të vitit 1981 në Kosovë, kur posaçërisht bënë agjitim për brohoritjen e parullës «Kosova republikë».

Sulm i paskrupull kundër rregullimit tonë shoqëror

Pasi të akuzuarit Rexhep Maqedonci, Adem Prapashtica, Lutfi Maqedonci, Nusret Ahmeti, Kadri Cakiqi dhe Adem Dervisholli, në shtëpinë e Abdullah Prapashticës në Prishtinë formojnë organizatën ilegale armiqësore «PKMLSHJ», në mbledhjen solemne që e hap Adem Prapashtica, e pastaj Abdullah Prapashtica e Osman Osmani, të cilat gjenden në arrati, njoftohen edhe me programin dhe ideologjinë e organizatës, si dhe përcaktajnë detyrat konkrete për aksionet e mëtejme dhe masivizimin e saj. Po kështu, ata marrin edhe

Kadri Cakiqi «Kulla», e kështu me radhë.

Këta të akuzuar, pas disa mbledhjeve të tjera, më 1 mars të vitit 1979 i dërgojnë «informate» prej tërë faqesh Kryesisë së KK të LK të Kosovës e Kryesisë së KSA të Kosovës dhe kryetarit të RSFJ-së, shokut Tito. Më pastaj, më 30 maj të vitit 1979 përgatitin «Infor-



Nga gjykimi i djeshëm i pjesëtarëve të organizatës armiqësore «PKMLSHJ»: i akuzuari Rexhep Maqedonci gjatë mbrojtjes së tij

KËMBËNGULËS PËR VEPRIMET ARMIQËSORE

I akuzuari Rexhep Maqedonci për veprimtarinë e tij armiqësore nuk mohoi asgjë, por në të kundërtën edhe më e plotësoi aktakuzën dhe detajisht shpjegoi rolin e tij në këtë organizatë, në të cilën ishte njëri prej «sekretarëve». Me këmbëngulje u mundua disa herë të bind trupin gjyqësor se «PKMLSHJ» u formua më 1975 dhe se platforma e saj u verifikuar më 1977, e jo një vit më vonë, si thuhet në aktakuzë.

Rexhepi tentoi disa herë të lexoj letrën që e kishte në dorë me të cilën do të tregonte «afësitë» e tija dhe të arsyetojë (sipas idesë së tij armiqësore) kërkesën që Kosova të bëhet republikë. Madje, përkundër se e ndërpreu disa herë kryetari i trupit gjyqësor, ai prapë insiston të lexojë atë letër, që fund e krye ishte armiqësore.

Ai shfrytëzoi rastin të përsërisë akuzat që sijnë për çdo ditë përmes propagandës armiqësore nga udhëheqësia e Shqipërisë për «Revizionizmin dhe unitarizmin jugosllav», «për hegemonizmin dhe shovenizmin serb», për gjoja «pozitën e pabarabart» të kombësisë shqiptare, e t.j. Ai nuk lejoi mbrojtësin e vet Zeqir Arnin që për të ta thotë asnjë fjalë.

Është interesant se sipas këtij të akuzuari, «Partia» e tyre «është formuar në principet e LKJ e të LNC-së» dhe se ideja për formimin e republikës shqiptare në Jugosllavi «është me vend dhe e drejtë». Kështu, përkundër të gjitha kamufllazheve dhe parullave demagogjike të «Partisë» së tij, edhe njëherë, qartë vërtetoi qëllimet e vërteta të kësaj organizate armiqësore dhe të anëtarëve të saj.

pseudonimet: i akuzuari Rexhep matën» prej tërë faqesh për Maqedonci merr emrin konspira- situatën politike e ekonomike në titiv «Kondori», Adem Prapashtica «krahinat shqiptare të bashkuara «I Qeti», Nusret Ahmeti «Neka», vullnetarisht Jugosllavisë», të

cilën ia dedikojnë organizatave politiko-shoqërore shqiptarë në Jugosllavi dhe i dërgojnë në shumë adresa të organizatave politiko-shoqërore në KSAK si dhe i hedhin në disa oborre të shtëpive në Prishtinë, me të cilat informata botërisht njoftojnë strukturat shoqërore për ekzistimin e «PKMLSHJ» dhe qëllimet e saj, siç janë: bashkimi i krahinave shqiptare në RSFJ, pavarësia territoriale, politike dhe ekonomike nga RS e Serbisë, RS e Maqedonisë e RS e Malit të Zi dhe formimi i Republikës socialiste shqiptare në Jugosllavi». Më 11 mars të vitit 1980, në adresë të udhëheqësve më të lartë të KSAK dërgojnë «Letër interne» dhe «Notë». Pas vdekjes së shokut Tito, më 5 maj të vitit 1980, në emër të «Presidiumit të KQ» të «PKMLSHJ» i dërgojnë telegram ngushëllimi Kryesisë dhe KQ të LKJ. Ndërsa, më 10 dhjetor të vitit 1980, strukturave shoqërore-politike shoqërore i dërgojnë «Projektin» e materialit të organizatës së tyre ilegale armiqësore, në formë të broshurës prej 150 faqesh, që bashku me «Dekretin» ku jepet urdhrë që brenda vitit 1981 të kryhen detyrat programore lidhur me shpërthimin e demonstratave armiqësore e kundërrivolucionare. Anëtarët e kësaj organizate, më 11 e 26 mars dhe 1 e 2 prill të vitit 1981 plasojnë platformën e tyre dhe marrin pjesë aktive në demonstrata dhe insistojnë në mesin e demonstruesve që të përdoret parulla «Kosova Republikë» e pastaj shkruajnë parulla dhe shpërndajnë afishe me përmbajtje armiqësore. Më 14 prill të vitit 1981, i dërgojnë «notë», KQ të LKJ me ç'rast marrin përgjegjësinë për organizimin e demonstratave.

Po këta të akuzuar, më 30 maj të vitit 1981 i dërgojnë letër KK të LK të Kosovës, të gjitha komitetetve komunale, të gjitha sekretariatetve të punëve të brendshme në Kosovë, ku bëjnë fjalë për gjendjen politike e ekonomike të viseve shqiptare në Jugosllavi. Më 5 qershor të të njëjtit vit i dërgojnë letër Kryeredaktorit të «Borbës», Marko Loliqit. Më 14 gusht 1981, KQ të LKJ dhe qeverisë jugosllave i dërgojnë «Letër» dhe ftojnë LKJ-në për bisedime si partner e parti të barabarta. Aktivitetin e tyre ilegal armiqësor ata pastaj e vazhdojnë me shpirtin dhe shumëzimin e fletushkave: «Teoria dhe praktika e revolucionit», «Revolucioni», «Zëri i atdheut», etj në të cilat fletushka në mënyrë të paskrupull sulmohet rregullimi shoqëror në RSFJ. Ata shkruajnë edhe afishe dedikuar pionerëve dhe një afish formë letre me të cilën u drejtohen pjesëtarëve të kombësisë serbe, maqedonase e pjesëtarëve të tjerë që jetojnë në viset ku banojnë shqiptarët.

Kur u formua organizata armiqësore «PKMLSHJ»?

I akuzuari i parë, Rexhep Maqedonci, në mbrojtjen e tij, që në fillim deklaroi fillim nuk pajtohet me thënie të aktakuzës duke shtuar se nuk janë themelues të organizatës armiqësore «PKMLSHJ» Sipas tij, kjo organizatë u formua më 1975 e jo më 1978. Si thotë, në verë të vitit 1977, në shtëpinë

Siç dëshmon gjyqi kundër PKMLSHJ më 8.2.1983, Rilindja shpesh përdorte edhe gjuhën e armikut

Pos këtij grupi të madh veprimtarësh atdhetar të dënuar nga pushtuesi jugosllav dhe bashkëpunëtorët e tyre shqipfolës, u arrestuan, torturuan dhe dënuan në gjyq herë gjysmë të mbyllura herë të jo publike edhe disa grupe që kanë vepruar në kuadër apo nga platforma e PKMLSHJ-së.

Të gjithë ata që nuk kanë pasur rast e mundësi të lexojnë synimet programore dhe statutin e Organizatës për Republikë – PKMLSHJ, atë mund ta lexojnë në vegën e bashkangjitur këtu:

<http://www.pashtriku.org/index.php?kat=60&shkrimi=2537>

SEKRETARIATI OPERATIV E EKZEKUTIV PËR FERIZAJ, KAÇANIK E VITI - VAHEDIN AZEMI ME SHUMË SHOKË E SHOQE

Gjyqi i Qarkut në Gjilanit, me kryesuesin e seancës Bajram Kadriu, gjyqtar, sipas Aktakuzës së PPQ në Gjilan PP.nr. 24/82, në prezencën e zëvendës prokurorit publik të qarkut në Gjilan Nasuf Nasufit, të akuzuarit për vepra penale: *“shoqërim për shkak veprimtarisë armiqësore nga neni 136 par. 2 të LP të RSFJ”*, pas hetimeve që zgjatën disa muajsh të shoqëruara me tortura shtazarake dhe pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më 2, 3 e 4 gusht të vitit 1982, veprimtarët atdhetarë të akuzuar nga gjyqi armik me sloganin demagogjik, të përsëritur edhe në të gjitha gjyqet politike kudër bijve dhe bijave më të mira të popullit tonë “në emër të popullit” i dënuan: **Vahedin Azemi – me 10 vjet burg; Shyqeri Gjinolli – me 5 vjet burg; Shukri Musliu – me 2 vjet burg; Ymer Halimi- me 1 vjet e 6 muaj burg; Nazim Azemi – me 3 vjet burg; Xhevat Haziri – me 2 vjet burg; Sabit Haliti – 1 vjet e 6 muaj burg; dhe Daut Azemi – me 10 muaj burg.**

Arsyetimin e *“fajësisë”* së Wahedin Azemit, i caktuar nga Organizata me detyrën e sekretarit operativ e ekzekutiv për Ferizaj Kaçanik e Viti, gjykata e argumenton me faktin se ai i është bashkëngjitur organizatës...PKMLSHJ dhe gjersa është burgosurën ka vepruar mënyrë aktive dhe të organizuar përmes **Faton Toapllit dhe Abdullah Prapashticës e Osman Osmanit. Wahedin Azemi, njashtu si Sjqyeri Gjinolli**, i caktuar me detyrë nga Organizata si Sekretar organizativ për regionet në fjalë, së pari janë organizuar bashkë me familjarët e vet të shumtë atdhetarë, kanë bashkëvepruar edhe me shumë veprimtarë atdhetar të komunës së Vitisë, Gjilanit, Ferizajt, Kaçanikut, Prishtinës dhe më gjerë. Pos emrave të veprimtarëve të lartpërmendur ata kanë bashkëpunuar e bashkëvepruar edhe me; **Fatmir Bajramin, Ramush Topallin, Fatmir Abdullahun, Xhevahire Abdullahun, Skender Hajdarin, Muhabi Azemin, Ismet Azemin, Xhemajl Rashitin, Hamzë Azemin, Hysen Shehun, Naser Kukën, Hasan Selimin, Bajram Shaqirin, Ferinaze Isufin**, e shumë veprimtarë tjerë...



Bashkëveprimtarët Shyqeri Gjinolli e Wahedin Azemi, sekretari operativ e ekzekutiv i PKMLSHJ për Ferizaj, Kaçanik e Viti dhe përgjegjës për komitetit studentor nga PKMLSHJ

Disa nga ketë veprimtarë atdhetarë janë dënuar në gjyqe të ndryshme me shumë vit burg. Të gjithë këta me ditë e natë kanë shtypur, shumëzuar – ndër të tjera revistën **“Revolucioni”** dhe **“Zërin e Atdheut”** (në rreth 120 ekzemplarë), **Statutet e Organizatës dhe Instruksionet për punë praktike**, **Dekretin nr. 1 e 2** (në 400 ekzemplarë), të cilat më pastaj edhe i kanë shpërndarë gjithandej bashkë me mijëra e mijëra pamflete, trakte e revista me përmbajtje atdhetare e revolucionare, *“...duke u angazhuar konkretisht që – siç thekson edhe aktgjykimi - që Kosova të merr statusin Republikë!”*

SHËNIMI I NJËVJETORIT TË DEMONSTRATAVE

Në vrugun e përgatitjeve bashkë me shokë e shoqe tjera edhe të Prishtinës për shënimin e 1 vjetorit të demonstratave gjithëpopullore të '81-shit po me demonstrata, ndodh edhe arrestimi i gati 100 pjesëtarëve aktivë. Është me rëndësi të theksohet fakti se gjykimi i tyre – përpos ai i veprimtarëve të Organizatës së qendrës në Prishtinë, gjykimet e grupeve me veprimtarë tjerë të Organizatës qendrat tjera të Kosovës mbahen të fshehura dhe nuk publikohen në mjetet e informimit të atëhershëm publik.

GRUPI I KADRIJE GASHIT DHE AI I RAFIZ HALILIT

Mbështetur në Aktgjykimin 20 faqesh të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P-nr. 65/82, të datës 23 korrik 1982, kryesuar nga kryetari i kolegjit- gjyqtari Aziz Rexha paraprirë nga padia penale nga neni 172 paragrafi 1 i LPK, të përfaqësuar në seancës gjyqësore nga zëvendës prokurori publik Miftar Jasiqi më 22 e 23 korrik 1982, si dhe mbështetur në Aktakuzën PP. Nr. 291/81 të 13 majit 1982, si dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-kzh-nr. 93/83, të datës 16 shtator 1982, të kryesuar nga kryetari i kolegjit Tadej Rodiqi... për angazhimin e tyre në drejtim të krijimit të Republikës Socialiste Shqiptare në RSFJ, edhe përkundër faktit se kjo kërkesë nuk ishte e sanksionuar me ligjet e atëhershme në fuqi, pas arrestimit të tyre në mes të muajit nëntor të vitit 1981, (në dokumentet e organeve gjyqësore të pushtesit qëndron ky formulim *“koha e kaluar në vend të caktuar prej datës 16 nëntorit deri më 23 dhjetor 1981”* ?!), më pas paraburgimit dhe hetimeve të pandërprera rreth 7 mujore e deri në organizimin e procesit politik gjyqësor, përmes shërbëtorëve (hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve) shqipfolës, pas torturave fizike e psikike nga më të ndryshmet, të përcjella edhe me presion karshi familjarëve e farefisit të tyre,(...) dënuan me shumë vite burg, të10 (dhjetë) atdhetaret dhe atdhetarët shqiptarë: **Kadrije Gashi-me 6 vjet burg; Nazmi Shahini – me 4 vjet burg; Rafiz Haliti – me 5 vjet burg; Shaip Veseli – me 4 vjet burg; Ali Biba – me 2 vjet burg; Reshat Gashi – me 1 vjet e 6 muaj burg; Ruzhdi Shahini – me 2 vjet e 6 muaj burg; Imer Shahini – me 2 vjet burg; Arif Shahini – me 5 muaj burg dhe Lumnije Azemi (e mitur) – me 1 vjet burg.**



Kadrie Gashi para gjyqit armik bashkë me shokë të tjerë, ishin grupi i parë i zbuluar i PKMLSHJ në nëntor 1981

Dëshmitë dokumentuese të lartpërmendura vejnë në pah se grupi atdhetar i Kadrije Gashit e Nazmi Shahinit, si dhe grupi i Rafiz Halilit janë formuar dhe kanë vepruar nga platforma e PKMLSHJ dhe në bazë të statuteve dhe programit të kësaj organizate, ku si detyrë kryesore parashihej krijimi i Republikës Socialiste Shqiptare në RSFJ, duke ndjekur, së pari; mënyrën dhe rrugën paqësore, përmes ujdisë dhe marrëveshjes politike mes krerëve të pushtetit të Kosovës dhe atyre të Jugosllavisë, së dyti; me metoda të kombinuara, përmes presionit politik me greva dhe demonstrata, dhe së fundi; përmes kryengritjes dhe luftës së armatosur çlirimtare...”.

“...Këto grupe (atdhetarësh – v. i.) janë furnizuar me materiale programore dhe propaganduese, të cilat edhe i kanë përpunuar, shumëzuar dhe kanë shpërndarë afishe, si “Dekreti nr. 1 dhe 2. se janë angazhuar për zgjerimin e grupeve me anëtarë të rinjë dhe se kanë paraparë edhe formimin e grupeve të tjera...”dhjetëshe”...”.

Në vijim mund të lexoni edhe intervistën e ish-verpimtarës së PKMLSHJ-së, Kadrije Gashi Myrtaj dhënë të mirënjohurës Radio Kosova e Lirë: <http://www.radiokosovaelire.com/arbane-qeriqi-interviste-me-veprimtaren-dhe-te-burgosuren-politike-kadrie-gashi-myrtaj/>

EDHE VAJZA TË MITURA NË FRONT TË PARË TË LUFTËS PËR LIRI

Me rastin e Konferencës shkencore të mbajtur me 2 dhe 3 prill 2010: VEPRIMTARIA E GRUAS NË LËVIZJEN KOMBËTARE PËR ÇLIRIM, botuar edhe në formë vepre nga Instituti Albanologjik i Prihtinës në bashkëpunim me SH.B.P.K., Prishtinë 2010, veprimtarja që nga rinia e hershme, Lumnije Azemi – Morina, në Kumtesën e saj me titullin Femra shqiptare e rrethit të Ferizajt në lëvizjen ilegale për çlirim

kombëtar, (faqe 195-211 ndër të tjera) në pjesën mbi Organizatën ilegale atdhetare PKMLSHJ, ndër të tjera shkruan; “...Në procesin gjyqësor, zhvilluar me 22 dhe 23 korrik 1982, nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës, kundër 10 veprimtarëve të kësaj organizate ilegale atdhetare nga rrethi i Ferizajt dhe Shtimes (Shtimja në atë kohë ishte pjesë e Komunës së Ferizajt), u dënuan edhe dy anëtarë të kësaj organizate: **Kadrije Sherif Gashi dënohet me burg prej 4 vjet, ndërsa Lumnije Sabri Azemi dënohet me burg për të mitur prej 1 viti...**”



Lumnije Azemi – Morina u angazhua për pajtim të gjaqeve në Kosovë, në vitin 1982 edhe pse e mitur u dënua me 1 vjet burgim

Në këtë kumtesë përpos emrave të veprimtareve të dënuara me burg, Kadrije Gashit dhe Lumnije Azemit përmenden edhe emrat e veprimtareve të angazhuara në këtë organizatë, si: **Xhevahire Abdullahun, Xhevahire Rrahmanin, Hanumshahe Begisholli, Mikreme Demiri, Teuta Zymberi, etj. nga Ferizaj me rrethinë, si dhe Zyrafete Krasniqin, Fahrije Osmanin, Nazmije Sylja, etj. nga Prishtina me rrethinë...**


PKMLSHJ LEJONTE VEPRIME TË PAVARURA E QENËSORE TË GRUPEVE BRENDA SAJ

Veprimtari dhe i dënuari politik Naser Kuka, në librin e tij me kujtime e dëshmi, NGA LËVIZJA ILEGALE TE UCK, botuar SH.B.P.K Prishtinë 2012 (faqe 56-57) ndër të tjera shkruan: “...Pas rënies në kontakt me Faton Topallin (ish-drejtues i PKMLSHJ – v. i.), Sejdi Sejdiun (dëshmorë i UCK-së, i rënë heroikisht në Epopenë e Jezercit), Afrim Abazin (i mbytur me torturë mizore në muajin mars 1982 dhe i hedhur nga katet e larta të ish SPB-së në Ferizaj)..., më pastaj me (ish-drejtuesin tjetër të PKMLSHJ – v. i.) Vahedin Azemin (mesi i vitit 1981 – mars '82) një punë e përbashkët, pak më e shtrirë dhe më konkrete, ishte bërë me PKMLSHJ-në...”

Më tej në vijim (faqe 131) autori kujton: “... Në takimin e parë me ta, të mbajtur në Fidanishte (vend në periferi të Ferizajit) do të njihemi me Sejdi Sejdiun, Fehmi Hajrullahun, Fatmir Abdullahun, Fatmir Bajramin, Afrim Abazin dhe Imri Ilazin, por më pas veprimtarinë përbashkët do ta vazhdojmë me Fatonin...Nga Fatoni që nga takimet e para do të furnizohemi me materiale të PKMLSHJ-së, si: **‘Programi dhe Platforma e PKMLSHJ-së’, ‘Teoria dhe praktika e revolucionit’, ‘Zëri i Atdheut’, ‘Revolucioni’,...**”

ndërsa për nevoja të ngutshme, për shfrytëzim të përkohshëm nga ai do ta pranoni edhe një makinë shkrimi...”

(faqe 140)... “Meqë në dokumentet për nevoja të brendshme të PKMLSHJ-së lejoheshin edhe veprime vetanake, të pavarura të grupeve brenda saj dhe pasi që lexim kisha vepra të ndryshme që trajtonin çështjen shqiptare para, gjatë dhe pas luftës së dytë botërore, si dhe duke i pasur për bazë rrethanat e reja të krijuara pas demonstratave të vitit 1981, kisha vendosë që të përpiloja një notë...”



Pamje nga libri me kujtime e dëshmi të veprimtarit atdhetar Naser Kuka “NGA LËVIZJA ILEGALE TE UÇK”

Edhe ky grup veprimtarësh atdhetarë, si shumë të tjerë, u dënuan nga pushtuesi jugosllav përmes bashkëpunësorëve shqipfolës, duke u mbajtur edhe procesi gjyqësor kundër tyre në fshehtësi nga opinioni publik:

“...Gjykata e Qarkut në Prishtinë, më datën 17 korrik 1982, i ka shpallur fajtor për vepër penale të bashkimit për veprimtari armiqësore, të parashikuar nga neni 136 par. 2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ dhe i ka gjykuar (dhe dënuar këta atdhetarë – v. i.): **Naser Kuka – me 4 vjet burg, Hysen Shehu – me 3 vjet e 6 muaj burg, Sejdi Sejdiu – me 3 vjet burg, Fehmi Hajrullahu – me 3 vjet burg, ndërsa për vepër penale të propagandës armiqësore, nga neni 133 par. 1 të LP RSFJ Ymri Ilazi – me 2 vjet e 6 muaj burg, Islam Vishi – me 2 vjet burg, Fatmir Bajrami – me 2 vjet burg, dhe Fatmir Abdullahu – me 1 vjet e 6 muaj burg...**”(marrë nga Aktgjykimi P-nr. 84/82).

GRUPI I INTELKTUALËVE TË KOSOVËS

Mr. Halil Alidema, themeluesi i këtij grupi intelektualësh (shih aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, PP.nr. 281/81, të datës 31 maj 1982, Prishtinë): “...që nga viti 1979 në takime dhe gjatë

bisedave me **Hilmi Retkocerin dhe Nezir Halitin** si dhe persona tjerë në Ferizaj, përhapte qëndrimet e tij në drejtim të realizimit të statutit për Republikën (shqiptare v. i.) të Kosovës dhe bashkimit të popullit shqiptare pastaj pas demonstratave të muajit mars prill 1981, në shumë takime kontaktuese, ndeja dhe gjatë bisedave me **Ekrem Kryeziun, Ukshin Hotin, Mentor Kaçin, Hilmi Retkocerin, Ali Kryeziun, Nezir Halitin, Shemsi Reçicën dhe Muharrem Fetiun**, në Prishtinë, Ferizaj dhe gjetiu, i përkrahi në tërësi demonstratat, kërkesat dhe parullat e këtyre demonstratave...”.



Gjykimi i intelektualëve të Kosovës me në krye Halil Alidemën e Ukshin Hotin që si rrallë kush mbrojtën publikisht kërkesën për Republikë!

Nga shumë mbledhje maratonike që mbajtën strukturat e pushtetit të atëhershëm në UP, vlen të veçohet mbledhja e OB të LK-së e mbajtur më 19 nëntor 1981 në Fakultetin Filozofik, Dega Filozofi - Sociologji, në të cilën Ukshin Hoti si i vetmi politikan dhe kuadër i specializuar i Kosovës në fushën e marrëdhënieve politike ndërkombëtare, bëri shtjellimin shkencor të kërkesës për Republikë të shtruar nga studentët, në demonstratat e pranverës së atij viti. Pas atyre që i dënuan demonstratat fjalën e mori Ukshin Hoti, i cili tha: *“Ne duhet të diskutojmë hapur për kërkesat e studentëve tanë”* dhe vazhdoi diskutimin e tij. Midis të tjerave tha tekstualisht, fjalë për fjalë: *“Sa e di unë, në Jugosllavi, jo vetëm që nuk është zgjidhur në praktikë çështja shqiptare, por as teorikisht nuk është zgjidhur kjo çështje si duhet”*, dhe filloi që këtë konstatim ta argumentojë nga pikëpamja e tij, nga shkencat politike. *“Të gjitha shkrimet që janë botuar për çështjen kombëtare, tha ai, edhe ato nga pikëpamja juridike, edhe kushtetuta nuk e kanë zgjidhur as teorikisht çështjen shqiptare në Jugosllavi”* dhe vazhdoi: *“Unë mendoj që kjo është kërkesë e arsyeshme, e drejtë...”*, dhe me një tonë të lartë përfundoi: *“Kosova duhet të jetë Republikë dhe ne duhet ta përkrahim Republikën”*. (Sh. Reçica, fq. 9 - 10.)

Më 21 nëntor 1981 ndodhi arrestimi dhe burgosja e Halil Alidemajt, Ukshin Hotit, Ekrem Kryeziut, Shemsi Reçicës, etj., të cilët u dënuan si *“Grup i intelektualëve”*, me akuzën për *“veprimtari armiqësore kundër shtetit jugosllav.”*

*“Pas tetë muajve sa zgjati procesi i hetuesisë, Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë ngriti aktakuzën PP. nr. 281/81, dt. 31 maj 1982, ndërsa Gjykata e Qarkut në Prishtinë, formoj një trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët: Isak Nishevci, Ismet Emra e të tjerë, dhe në procesin gjyqësor të mbajtur më 21 korrik 1982, ku prokurorinë e përfaqësoi Miftar Jasiçi – zëv. Prokuror „në emër të popullit“ u dënuan këta intelektualë: **Halil Alidema (1936), Pozharan, mr. i historisë - 11 vjet burg; Ukshin Hoti (1943) Krushë e Madhe, mr. i shk. politike - 9 vjet burg; Ekrem Kryeziu (1943), Pejë, regjisor - 8 vjet burg; Mentor Kaçi (1952), Gjakovë, momtazher në TVP - 7 vjet burg; Hilmi Ratkoceri(1955), Llugaxhi, absolvent - 3 vjet burg; Ali Kryeziu (1950), Pejë, jurist - 5 vjet burg; Nezir Haliti (1948), Firajë, profesor - 2 vjet burg; Shemsi Reçica (1952), Gllavicë, profesor - 7 vjet burg; Muharrem Fetiu (1945), Peçan (Suharek), mr. i historisë - 6 muaj burg**”.* (Dr. Keçmezi-Basha, faqe 179/180)

Trupi gjykues, në aktgjykim ka konstatuar se ata kanë kryer *“... vepra penale të drejtuar në rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore dhe të punonjësve, thyerjen e “vëllazërim - bashkimit”, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ-së...”* (po aty) slogane këto që përsëriteshin në të gjitha aktakuzat dhe aktgjykimet e grupeve, që dënoheshin në vitet 80'ta në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare. Ukshin Hoti u dënu me 9 vjet burg, por duke qenë se aktgjykimi i shkallës së parë s'kishte asnjë bazë juridike për një dënim kaq të lartë, gjykata supreme më 11 qershor 1984, u detyrua t'ia zbriste dënimin në 3,5 vjet burg.

OFICERI I “APJ”-SË - KËSHILLTAR PËR ÇËSHTJE USHTARAKE PRANË PKMLSHJ

Dëshmi mbi procesin e gjyqit ushtarak kundër njërit nga oficerët e vetëm të “APJ”-së, që asokohe ishte i organizuar në ilegale atdhetare shqiptare, **SKENDER IBISHIT**, i lindur më 26.12.1956 nga Prishtina, atëkohë me banim në Valjevë, ish-Toger i APJ, me detyrë në Postën Ushtarake 6734 në Valjevë, kishte të kryer Gjimnazin dhe Akademinë Ushtarake, i arrestuar nga mesi i muajit maj 1982.

BISEDË:

SKENDER IBISHI, ISH – EPROR
USHTARAK, I BURGOSUR
POLITIK

FORCËN TONË NUK MUND TA THYEJË ASGJË

Skender Ibishin, ish togerin e armatës jugosllave, i cili gjashtë vjet e gjysmë kaloi nëpër burgjet dhe kazamatet jugosllave, e takuam këtyre ditëve dhe me të biseduam për shumë aspekte të jetës dhe të veprimtarisë së tij, qoftë si oficer, qoftë si veprimtar ilegal politik si dhe për jetën në burg. Zoti Ibishi është për aq më karakteristik, meqë, pa dyshim, është një nga eprorët e rrallë të armatës jugosllave, i cili ishte i organizuar në aktivitetin ilegal të Kosovës, që atëbotë ishte e vetmja formë e mundshme për të zhvilluar luftën drejt lirisë. Zoti Skender Ibishi sot jeton në Prishtinë, duke ndarë fatin e të gjithë bashkëkombasve të vet të terrorizuar kolektivisht, por duke shprehur optimizmin e fortë për fitorën reale në këtë luftë për liri.

KOSOVARJA: Nëse nuk gabohejmë ju zhvillimit aktivitetin ilegal kundër RSFJ-së në kuadër të PKMLSHJ-së (Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi). Do të ishte interesant të na thoni se si u rekrutuat në radhët e kësaj partie, për më tepër kur si ushtarak që ishit, në mënyrë kontinuitive i jeni ekspozuar një propagandë të tmerrshme për asimilim kombëtar, shpirtëror dhe politik në atë frymë unitare që mbreteronte në armatë?

SIBISHI: Diku nga viti i tretë i shkollës së mesme ushtarake, më 1973 në Beograd pas një ligjerate të një arsimtari të quajtur Gavriloviq, kur fitej për pozitën juridiko-kushtetutare të republikave dhe krahinave në sistemin politik të RSFJ-së, nga kureshija, profesorit të përmendur i parashitova pyetjen: "Përse krahinat autonome

konkretisht Kosova, nuk mund të jetë republike. Më kujtohet se profesori fillimisht u hutua dhe duke u përmbledhur pas ca do të më pergjegjëj shkurt: "Meqë nuk mund të ekzistojnë dy shtete shqiptarë", arsyetim ky i cili për mua i zbehtë dhe absolutisht i pajustificueshem. Është interesant ta them se edhe kjo pyetje e "padëshirueshme" hyri në dosjen e organeve hetuese gjatë trajtimit tim në burgun hetues, madje ishte edhe baza për fajësimin tim, me pretekst se gjoja, unë që më parë paskam qenë i organizuar në organizatë ilegale, madje-madje i rekrutuar dhe i dërguar qëllimisht në shkollim ushtarak. Rasti i lartpërmendur, pa dyshim se ishte edhe fillim i të menduarit tim për çështjen shqiptare dhe pozitën e tyre në Jugosllavi. Kështu që, pas kësaj, gjatë pushimeve verore që do t'i kaloj në Prishtinë më shokët e mij, Abdullah Prapashtica, Osman Osmani, Kadri Cakiqi, Bahtir Ahmeti dhe Nusret Ahmeti, do të më bjerë shumë shpesh dhe gjatë të bisedojmë për çështje të po kësaj natyre të cilat nga dita në ditë do të më bëhen preokupim gjithnjë e më i madh. Dhe kështu, pas bisedave të ketilla, Osmani sikur do ta fitonte bindjen se edhe unë do të mund të kyçesha në organizatën ilegale, që ishte formuar kohë më parë. Dhe kur më propozuan këtë, unë ofertën e



Skender Ibishi

Bisedoi: Haqif MUI
Foto: Muharrem M.I

Intervista e Haqif Mulliqit me Skender Ibishin pas daljes nga burgu, në fillim të viteve të 90-ta

Sipas arsytimeve në akuzësën ushtarake, Skender Ibishi:

"...në janar 1978 zgjidhet në udhëheqësin e ngushtë të Organizatës në "Komitetit Qendror" me detyrë "Këshilltar për Çështje Ushtarake", me ç'rast janë precizuar detyrat e tija si dhe iu kanë dhënë udhëzimet si të veprojë..., si dhe nëpërmjet të gazetave dhe revistave ushtarake në mënyrë adekuate të propagandojë ideologjinë e kësaj Organizate, në kuptimin e njoftimit me situatën ekonomike dhe pozitës së popullit shqiptar në Kosovë dhe në RFSJ, në realizimin e detyrave të marra përsipër dhe qëllimeve të lartpërmendura, duke vepruar në pajtueshmëri me 'Platformën' e aprovuar të Organizatës, ... me qëllim përfitim i për anëtarësim në Organizatë, për krijimin e grupeve të reja dhe zgjerimin e ideve të Organizatës në radhët e ushtarëve, ashtu që sipas metodologjisë paraprakisht të aprovuar ka zhvilluar bisedat mbi situatën e vështirë ekonomike dhe politike në Kosovë, për pakënaqësinë e popullit e posaçërisht të rinisë, që udhëheqja është e paaftë të zgjidhë këto çështje, që Kosovën e shfrytëzon Serbia, që një situatë e tillë duhet ndryshuar dhe se kjo situatë ndryshon nëse Kosova merr statutin e Republikës, që shqiptarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës gjenden në një pozitë edhe ma të pabarabartë në krahasim me kombet tjera,... dhe në rast të vlerësimit se ka përvetësuar bashkëbiseduesit, ka folur se në Kosovë ekzistojnë Organizata të cilat luftojnë që Kosova të bëhet Republikë,... ka mbajtur kontakte të rregullta me anëtarët e udhëheqjes së Organizatës, posaçërisht me Osman Osmanin dhe Abdullah Prapashticën, të cilët i ka informuar mbi veprimtarinë tij dhe të arriturat e punës, ndërsa nga ta ka pranuar instruksionet për punë të mëtejme,...".

Më tej në padinë e paraqitur nga prokuroi ushtarak pranë Gjyqit Ushtarak në Beograd potencon se: *“...Thelbi i qëllimeve ... të PKMLSHJ del nga platforma e saj ‘dokumentet partiake’, të cilat pos tjerash në vijat e tërësishme parashohin ndryshimin e statusit të pakicës kombëtare dhe njohja e popullit shqiptar që jeton në trojet e veta e i cili në pjesët e RSFJ të banuara me shqiptarë është numerikisht më i madh se serbet, malazezët dhe sllavët e Maqedonisë. Platforma kërkon që nga ‘këto vise’ të formohet Republika Socialiste e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë, e cila pra, do të përfshinte edhe pjesë tjera të RSFJ në të cilat jetojnë kryesisht shqiptarët. Rregullimi i brendshëm i ‘Republikës së Kosovës’ do të rregullohej përmes kombinimit të Kushtetutës së RSFJ dhe RPS të Shqipërisë...*

Platforma parasheh realizimin e qëllimeve të lartpërmendura në tri faza – duke filluar nga masivizimi i Organizatës sipas principit të dhjetësheve, në konspiracion të rreptë dhe propagandës së gjerë, përmes demonstratave masive, ... deri te kryengritja e armatosur, në të cilin do të merrnin pjesë edhe pjesëtarët e APJ me kombësi shqiptare. Për kryengritje ndihma do të merrej nga jashtë, para së gjithash nga emigracioni shqiptar, e do të shfrytëzoheshin edhe armatimi i Njësive të Mbrojtjes Territoriale të cilat gjenden në organizatat punonjëse, bashkësitë lokale dhe komunat.

Karakteri ... i PKMLSHJ mund të shihet edhe në zëdhënësit e tyre “Revolucioni” (organi KQ të PKMLSHJ) dhe “Zëri i Atdheut” (fletushkë/Organ i Rinisë së Organizatës, v. j.). Kështu në zëdhënësin “Revolucioni” i vitit 1981 në thirrjen e përgjithshme dhe apelin drejtuar gjithë forcave progresive të Shqiptarëve në Jugosllavi, komunikohet kalimin në fazën e dytë të luftës për realizimin e qëllimit Kosova Republikë. Në këtë fazë parashihet kombinimi i aksioneve paqësore me aksione presioni, grevave dhe likuidimin e tradhtarëve të popullit shqiptar... Në “Zërin e Atdheut” gjithashtu shpallet kalimi në fazën e dytë dhe jepen detyrat konkrete pionierëve, rinisë, grave... “(Marrë nga Padia e ngritur nga Prokuroria Ushtarake Beograd, pran Gjyqit Ushtarak në Beograd). Shkrimin në tërësi për jetën dhe veprën e Skedner Ibishit mund ta lexoni në vegën vijuese: <http://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=572> .

EDHE BABË E BIRË TË DËNUAR POLITIKË

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P.nr. 100/86, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hilmi Zhitija, kryetar i kolegjit, në lëndën penale kundër atdhetarëve të akuzuar; Nysret Hajdari dhe Skender Hajdari (babë e bir – v. i.) nga Prishtina, “për shkak të veprës penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136. alineja 2. lidhur me nenin 141 të LP të RSFJ”, pas përfundimit të seancës kryesore këta dy atdhetarë dhe veprimtarë të mirënjohur për pjesëtarët e të gjitha grupeve dhe organizatave ilegale të kohës – shtëpia e të cilëve u shërbente si bazë e sigurt dhe besnike – dënon; Nysret Hajdarin me 4 vjet burg; ndërsa të birin Skender Hajdarin me 3 (tre) vjet burg.




Baca Nysret Hajdari me bashkëveprimtarin Skender Ibishin dhe foto në veti Skender Hajdari

Në arsyetimin e Aktgjykimit ndër të tjera theksohet se:

*“...**Nysret Hajdari**....kah fundi i vitit 1982, është bërë anëtarë i “PKMLSHJ” (LRSSHJ, v. i.), e cila vepron kundër RSFJ, në atë mënyrë që në RFGJ ku ishte punësuar, nëpërmes të shokëve të tij **Nuhi Sylejmanit dhe Hasan Veselajt** ra në kontakt me krerët e emigracionit shqiptar **Abdullah Prapashticën** i cili mban*

pseudonimin “Burimi”, Faton Topallin i cili mban pseudonimin “Naimi” dhe Osman Osmanin me pseudonimin “Rexha”, të cilët e udhëheqin atë parti në shtetet e perëndimit, e pasi e përkrahu ideologjinë e tyre u obligua edhe vetë të veprojë armiqësisht kundër RSFJ e edhe veproi në atë mënyrë, që morri pjesë në demonstratat të mbajtura gjatë vitit 1982 në Bon të RFGJ dhe në Bernë të Zvicrës, prezantoi në përgatitjen e revistës “Punëtori”, “Kosovarja” dhe në punimin “Koment politik”, morri pjesë në varrimin e vëllezërve Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla si dhe Kadri Zeka, persona këta që janë të njohur për veprimtari ... ndaj RSFJ, me ç’rast morri materialin me përmbajtje armiqësore “Zëri i Kosovës”. Si anëtar i organizatës së cekur rregullisht ka paguar anëtarësinë mujore në shumë prej 50 DM, ndërsa në vitin 1983 më se tre muaj ishte në vendin e Kryetarit të “Komitetit Drejtues” si organ udhëheqës i organizatës...”.



Pjesa e ish PKMLSHJ-së që pa fajin e saj ishte e izoluar nga qasja dhe mundësia e shtypshkronjës së LRSSHJ dhe mjeteve të saja, bazuar në vendimet e Bashkimit të 17 shkurtit 1982, gjegjësisht 15 majit 1982 nxirrte rregullisht derin në fund të viteve të 80-ta revistën “Punëtorët” dhe kohë pas kohe trakte, fletushka e broshura tjera si dhe revistën “Kosovarja e re”

Baca Nysret Hajdari kishte bashkëpunëtorë të shumtë nga radhët e punëtorëve mërgimtarë në Gjermani, me të cilët bashkëvepronte për çështjen e atdheut, ndër të cilët - pa dashur deh pa pasur për qëllim me u hy në hak të tjerëve - unë po veçojë; **Nuhi Sylejmanin, Hasan Veselajn, vëllezërit Halil e Sefer Qoqajn, Sabit Topallin,** e shumë të tjerë, ndërsa në Zvicër po veçoj ndër shumë shokë; **Elfi Agushin, Ejup Ahmetin** dhe shokë e bashkëveprimtarë gjithandej nëpër vendet e Evropës perëndimore.

Ndërsa në arsyetimin e Gjykatës për të birin Skenderin, potencohet: “... **Skender Hajdari...** kah muaji shkurt i vitit 1982 nëpërmjet të **Vahedin Azemit** u vu në kontakt me **Fatmir Abdullahun** nga i cili disa ditë më vonë në shitoren e tij në Ferizaj morri materialet „Zëri i Atdheut“ dhe „Revolucionin“ si dhe „Programstatutin e PKMLSHJ“ e të cilat pasi i lexoi në tërësi u pajtua me brendinë dhe platformën e tyre u futë në radhët kësaj organizate dhe veproi në kuadër të saj, ashtu që gjatë verës së vitit 1982 në RFGJ, derisa ishte në vizitë tek babai i tij, i pandehuri i parë Nysret Hajdari kontaktoi me krerët e kësaj

organizate në RFGJ, Faton Topallin dhe Osman Rexhën (O. Osmanin – v. i.), pastaj në nëntor të vitit 1985 kontaktoi me Hajdin Abazin “Ganiun”, nga i cili mësojë për “MLK”, të cilën e udhëheq “Komiteti Organizativ”, në ndërkohë shkëmbejnë materiale në emër të të dy organizatave duke i dhënë vërejtjet e tyre për materialet e caktuara, për çka arritën marrëveshjen që të shqyrtohet mundësia e bashkimit-shkrires të këtyre dy organizatave në një organizatë për çka në dhjetor të vitit 1985, në shtëpinë e tij në Prishtinë, u takuan edhe me Fatmir Bajramin si përfaqësues të PKMLSHJ, me **Hajdin Abazin “Ganiu” dhe Xhavit Hazirin “Xhemajli” si përfaqësues të “Komitetit Organizativ të MLK”**, në të cilën mbledhje i pandehuri shprehu dëshirën për bashkim të tillë por për atë **do të vendosin pas konsultimit me Avdullah Prapashticën, Osman Osmanin dhe Faton Topallin**, me ç’rast u nënshkrua në proces me pseudonimin “Zef”,...

PROCESI I BASHKIMIT TË FORCAVE TË ILEGALES NË VEND

Një person që dua ta veçojë dhe që bashkë me Faton Topallin është personi kyç i Organizatës së Rinisë dhe i PKMLSHJ-së jo vetëm në Ferizaj, Anamoravë dhe rrethinë, por gjithandej nëpër viset shqiptare deri edhe në diasporë, është veprimtari Fatmir Bajrami. Ai është i lindur më 9 mars 1963 në Shkup, me vendbanim në Dardanë (ish Tankosiq) dhe në Ferizaj, **veprimtarinë atdhetare e zhvilloi kryesisht me bashkëveprimtarë tjerë në Ferizaj, Viti, Gjilan, Kaçanik, Prishtinë, Mitrovicë, pastaj edhe me bashkëveprimtarë të kohës nga Shkupi deri në Kërçovë, pra gjithandej nëpër Kosovë e vise tjera shqiptare. Shtëpia e tij në Ferizaj ishte bazë e aktivitetit atdhetar dhe strehë për ilegalët Veprimtar shumë i vendosur, por i heshtur, ishte i ndërlidhur dhe koordinonte punët e veprimtarinë mes grupet të ndryshme që vepronin nga platforma e PKMLSHJ, por ishte i lidhur edhe me veprimtarë e pjesëtarë të grupeve tjera atdhetare si me GMLK/OMLK dhe me MLK. (shih ndër të tjera: Aktgjykimin P-K.nr. 167/82; Aktgjykimi P-nr. 84/82; Aktgjykimin P-nr. 65/82; pastaj Aktgjykimin P-nr. 100/86, etj.)**

Fatmiri ishte shok me **dëshmorin Afrim Abazin**, të vrarë mizorisht pas torturave nga punëtorët shqiptarë e serbë të UDB-së në Burgun hetues të Ferizajt dhe me pastaj të hedhur nga kateve të larta të këtij Burgu, gjoja se ka bërë vetëvrasje...

Fatmiri ishte **lidhja organizative mes shokëve të ish-PKMLSHJ jashtë vendit me ata të brenda vendit** dhe përfaqësuesi i ish- PKMLSHJ në Kosovë deri në bisedimet dhe vazhdimin e bashkimit mes forcat tjera të ilegales atdhetare në vend – bashkë me Skender Hajdarit, deri në burgosjet e mëdha të vitit 1985/86, me ç’rast burgoset edhe vet Skender Hajdari bashkë me të atin Nysretin. Shih për këtë Aktgjykimin e lartpërmendur P.nr. 100/86, ku ndër të tjera theksohet: “...në nëntor të vitit 1985 kontaktoi me Hajdin Abazin “Ganiun”, nga i cili mësojë për “MLK”, të cilën e udhëheq “Komiteti Organizativ”, në ndërkohë shkëmbejnë materiale në emër të të dy organizatave duke i dhënë vërejtjet e tyre për materialet e caktuara, për çka arritën marrëveshjen që të shqyrtohet mundësia e bashkimit-shkrires të këtyre dy organizatave në një organizatë për çka në dhjetor të vitit 1985, në shtëpinë e tij në Prishtinë, u takuan edhe me Fatmir Bajramin si përfaqësues të ish-PKMLSHJ, me Hajdin Abazin “Ganiu” dhe Xhavit Hazirin “Xhemajli” si përfaqësues të “Komitetit Organizativ të MLK”, ...por për atë do të vendosin pas konsultimit me Avdullah Prapashticën, Osman Osmanin dhe Faton Topallin,...”

Më pas Fatmiri - ndër të tjera - angazhohet në **UNIKOMB-in e themeluar nga Halil Alidema**, nismëtarin e përpjekjeve për organizim ushtarak çlirimtar. Bashkë me shokë mbështeti me mjete financiare dhe logjistikë UÇK-në.



Fatmir Bajrami është aktiv edhe në jetën shoqërore e politike në Zvicër, si këtu me rastin e marshin solemn për 1 Maj 2013 në Schaffhausen

Në përgaditje për botim janë edhe **intervista e portretizime** të veçanta **me bashkëveprimtarë të kohës si të ish- PKMLSHJ-së e të ish-LRSSHJ-së**, e të cilat do ti publikojmë në një të ardhme të afërt.

Mbi rolin vendimtar të PKMLSHJ-së për iniciimin dhe themelimin e LRSZHJ-së mund të lexoni në vegën vijuese: <http://www.pashtriku.org/index.php?kat=60&shkrimi=1293>

PËRFUNDIM

Secili individ grup dhe organizatë në mënyrën e vet – bile edhe individë e kuadro të sistemit pushtues me veprime të caktuara të ditura e të paditura - kanë kontribuar dhe kanë bërë që këto demonstrata e ngjarje të ishin ashtu si me të drejtë edhe u cilësuan – gjithëpopullore. Ndërsa sa i përket grupeve e organizatave të veçanta, me një fjalë forcave politike shqiptare të kohës, ekzistojnë dëshmitë të mjaftueshme se cila forcë çfarë programi, cilat kërkesa ka pasur dhe cilën rrugë kanë ndjekur për realizimin e qëllimeve të tyre programore.

Andaj, ky shkrim paraqet një plotësim në mozaikun e një periudhe, që edhe sot e kësaj dite kultivon hapësirën politike të shqiptarëve. Kjo forcë politike, me njerëz e veprime konkrete, është organizatorja kryesore, e themeluar me qëllim të shtrimit dhe të organizimit të kërkesës për Republikë Shqiptare, me fazat e parapara të veprimit politik e aksionar.

Në këtë rrugëtim progresiv, të fundit u “bashkuan” edhe shumica e shqiptarëve që deri në fund të viteve të 80-ta dhe në fillim të 90-tave ishin besnikë të LKJ-së.

Jo rrallë eksponentë të caktuar kanë tentuar në vazhdimësi ose të injorojnë ose të monopolizojnë autorësinë e një lëvizje të tërë popullore duke anashkaluar me këtë rast gjithçka tjetër që bie ndesh me

interesat, pikëpamjet apo bindjet e tyre përjashtuese. Tërë këtë e bëjnë edhe në emër të njëfarë “meritokracie”, duke pretenduar kështu të arsyetojnë realizimin e interesat e tyre individuale grupore, arritjen e një prestigji më të madh, si dhe marrje dhe ruajtje të posteve politike e përfitimeve tjera edhe materiale.

Aktualisht që të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen solemne të PKMLSHJ-së të vitit 1978 janë ende gjallë. Shumica e tyre janë ndalë së vepruari për më se 40 vite. Ata nuk janë bartës të posteve apo funksioneve institucionale në Republikës së Kosovës, për të cilën pas punës atdhetare e revolucionare disavjeçare edhe në gojë të armikut, duke sakrifikuar personalisht, profesionalisht dhe familjarisht, janë arrestuar, torturuar (deri në vdekje - si rasti i Afrim Abazit) dhe dënuar me shumë vite burg, kanë ndihmuar e mbështetur aktivisht veprimtarinë e luftës paqësore të fillim-viteve të 90-te dhe që nga zanafilla e saj edhe luftën çlirimtare si materialisht si dhe drejtpërdrejt në luftën çlirimtare, pa kurser edhe jetën... Përderisa, mjerisht shumicën e vendim-marrësve politik, urdhër-dhënësve, hetuesve e ndjekësve, torturuesve dhe bashkëpunëtorëve e shërbëtorëve të ish-pushtuesit jugosllav e serb i kemi gjithandej nëpër institucione të **Republikës së Kosovës**, të cilën ata e kanë kundërshtuar keqas e luftuar me të gjitha mjetet e mundshme, duke mos ngurruar të shpifin paturpshën edhe deri në ditët e sotme..

Ndriçimi i këtyre ngjarjeve dhe roli i individëve e personaliteteve, grupeve dhe organizatave, mjerisht edhe sot e kësaj dite në përgjithësi ka mbetur në errësi apo është ndriçuar vetëm pjesërisht. Urojmë që tani e tutje, pas më rreth 40 vjetësh, të ketë një qasje më objektive, më shkencore dhe më gjithëpërfshirëse në raport me ngjarjet, si dhe të protagonistët, qofshin ata individ, grupe apo organizata. Kjo edhe për arsye se eksponent të caktuar të grupeve e organizimeve të ndryshme kanë shfrytëzuar mungesën e trajtimit objektiv e shkencor të këtyre ngjarjeve me rëndësi historike, edhe për të përvetësuar edhe më shumë merita, se sa në të vërtetë kanë.

Ky rrugëtim, me gjithë vështirësitë që përcjellin lëvizjet politike çlirimtare, më në fund edhe u jetësua - për të mos thënë pjesërisht - aq sa qe e mundur. Projektet në përgjithësi, pra edhe ato politike, rrallë se realizohen një për një. Megjithatë rezultatet e arritura, pa mëdyshje mund të cilësohen ngadhënjyese! Edhe pse gjeneratave të reja u kanë mbetur shumë punë për të bërë.

Osman Osmani, Prishtinë/Schaffhausen, mars 2013, e përpunuar në dhjetor 2016 - mars 2017

LITERATURA (REFERENCAT DHE BURIMET):

- Ahmet Qeriqi: Romani “BURGU”, botim i vitit 2004
- Aktgjykimi P-K.nr. 167/82; Aktakuza e Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë pp.nr. 152/82, 156/82, 158/82.
- Aktgjykim: Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P.nr. 100/86,
- Aktakuza PP. nr. 281/81, 31.05.1982, “Grupi i Intelektualëve”,
- Aktakuza PPPm Nr. 111/83, 5.XII.1983, Grupi “Shote Galica”
- Aktpadi: Gjyqit Ushtarak në Beogradit, 10.3. 1983; Aktgjykim IK. nr. 374/82-IV, Skender Ibishi, Toger në PU 6734 në Valevë,
- Aktakuza PPQ, në Gjilan PP.nr. 24/82, Seanca gjyqësore jopublike e 2, 3 e 4 gushtit 1982,

- Aktakuza PP. Nr. 291/81, 13.5.1982; Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P-nr. 65/82, 23.7.1982; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-kzh-nr. 93/83, 16.9.1982,
- Ethem Çeku: Libri “STRUKTURA POLITIKE E ILEGALES SË KOSOVËS”, botuar nga Argeta- LMG, Tiranë 2006,
- Ibrahim Çavolli (konsull i Shqipërisë dhe i dërguari i posaçëm i KQ të PPSH-së në Stamboll të Turqisë): Libri “Jam Kosovar...!” 2008, NB “Gjon Buzuku”, faqe 199,
- Kadrie Gashi'Myrtaj: ME URDHËRIN E KRIMINELIT MEHMET MALIQI, MË KANË TORTURUAR MIZORISHT INSPEKTORËT SHQIPTARË, HASAN MEHMETI, ADEM GOGA, HALIT LOKU...! Intervistë e Arbanë Qeriqit në Radio Kosova e Lirë,
- Lumnije Azemi – Morina: Kumtesa “Femra shqiptare e rrethit të Ferizajt në lëvizjen ilegale për çlirim kombëtar”, (faqe 195-211), Instituti Albanologjik i Prihtinës në bashkëpunim me SH.B.P.K ., Prishtinë 2010,
- Naser Kuka: Libri kujtime e dëshmi “NGA LËVIZJA ILEGALE TE UÇK”, SH.B.P.K Prishtinë 2012, faqe 56-57,
- Mr. Halil Alidema: Rilindja, 20.3.1996, “Pikëpamje: BUNTI ATDHETAR I PRANVERËS ‘81”,
- Prof. Dr.Izber Hoti:”ISMAIL DUMOSHI”, SHB “Faik Konica” Prishtinë 2011, faqe 222-223,
- Qerim Lita; Materiale nga Arkiva e Republikës së Maqedonisë, publikuar në të përditshmen informative KOHA, të datës 03 prill 2011,
- Ramadan Pllana: Shkrim në: <http://hogoshti.blogspot.ch/2011/10/xhavit-haziri-heri-i-merituar-nga.html>; Intervistë në: <http://hogoshti.blogspot.ch/2011/10/ramadan-pllana-interviste-ne.html>
- RILINDJA, 26.9.1981: “RAPORTI I KOMISIONIT PËR PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË MAHMUT BAKALLIT”, ,
- Sinan Hasani: “E vërteta dhe mashtrimet”, faqet: 26/27, 196//197, 198/199 dhe 200/201, Qendra për informata dhe publicitet, 1986, Zagreb